

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar  
Advanced Financial Reporting

**P9**

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data  
18.07.2020

CONTENT / PËRMBAJTJA

| Pjesa         | Maksimumi i Dhënë | <u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u> |
|---------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| 1. Problemi 1 | 30                |                                                                             |
| 2. Problemi 2 | 10                |                                                                             |
| 3. Problemi 3 | 20                |                                                                             |
| 4. Problemi 4 | 20                |                                                                             |
| 5. Problemi 5 | 20                |                                                                             |
| <b>Total</b>  | <b>100</b>        |                                                                             |

## Problemi 1

Shackleton sh.a ka kontroll dhe influencë domëthënëse në entitete të ndryshme. Në vijim janë pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit Shackleton sh.a.

### **Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:**

|                                                              | €'000           |
|--------------------------------------------------------------|-----------------|
| Të hyrat                                                     | 2,006.00        |
| Kosto e shitjeve                                             | <u>(752.00)</u> |
| Fitimi bruto                                                 | 1,254.00        |
| Kosto e shpërndarjes                                         | (624.00)        |
| Kosto administrative                                         | (424.00)        |
| Kosto financiare                                             | (72.00)         |
| Pjesa e humbjeve të ortakërisë                               | <u>(96.00)</u>  |
| Fitimi para tatimit                                          | 38.00           |
| Tatimi                                                       | <u>(15.00)</u>  |
| <b>Fitimi për periudhën</b>                                  | <b>23.00</b>    |
| <u>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</u>                   |                 |
| Neto përfitimet nga vlerësimet e ekspertëve (aktoriale)      | <u>8.00</u>     |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                   | <b>31.00</b>    |
| <i>Fitimi për periudhën i atribuar tek:</i>                  |                 |
| Mbajtësit e ekuitetit të prindit                             | 18.40           |
| Interesi jo-kontrollues                                      | <u>4.60</u>     |
|                                                              | 23.00           |
| <i>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse të atribuara tek:</i> |                 |
| Mbajtësit e ekuitetit të prindit                             | 26.40           |
| Interesi jo-kontrollues                                      | <u>4.60</u>     |
|                                                              | 31.00           |

**Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor:**

|                                                 | <b>2019</b>     | <b>2018</b>     |
|-------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
|                                                 | <b>€'000</b>    | <b>€'000</b>    |
| <u>Pasuritë</u>                                 |                 |                 |
| <i>Jo-qarkulluese</i>                           |                 |                 |
| Patundshmëritë, impiantet dhe paisjet           | 1,214.00        | 1,099.00        |
| Zëri i mirë                                     | 108.00          | 110.00          |
| Investimet në shoqëri                           | 227.00          | 414.00          |
| Tatimi i shtyrë                                 | <u>-</u>        | <u>40.00</u>    |
|                                                 | 1,549.00        | 1,663.00        |
| <i>Qarkulluese</i>                              |                 |                 |
| Stoqet                                          | 160.00          | 167.00          |
| Të arkëtueshmet tregtare                        | 224.00          | 263.00          |
| Paraja & ekuivalentët e parasë                  | <u>126.00</u>   | <u>60.00</u>    |
|                                                 | <u>510.00</u>   | <u>490.00</u>   |
| <b>Total pasuritë</b>                           | <b>2,059.00</b> | <b>2,153.00</b> |
|                                                 | <b>2019</b>     | <b>2018</b>     |
|                                                 | <b>€'000</b>    | <b>€'000</b>    |
| Ekuiteti dhe detyrimet                          |                 |                 |
| <u>Ekuiteti</u>                                 |                 |                 |
| Aksionet e zakonshme prej €2 secila             | 556.00          | 352.00          |
| Premia e aksioneve                              | 105.00          | 25.00           |
| Fitimet e mbajtura                              | <u>29.00</u>    | <u>39.00</u>    |
|                                                 | 690.00          | 416.00          |
| Interesat jo-kontrollues                        | <u>177.00</u>   | <u>185.00</u>   |
| Total ekuiteti                                  | 867.00          | 601.00          |
| <u>Detyrimet</u>                                |                 |                 |
| <i>Afatgjata</i>                                |                 |                 |
| Përfitimet e punonjesve                         | 358.00          | 476.00          |
| Tatimi i shtyrë                                 | 28.00           | -               |
| Detyrimi financiar – kredi bankare e pasiguruar | <u>444.00</u>   | <u>544.00</u>   |
|                                                 | 830.00          | 1,020.00        |
| <i>Afatshkurtëra</i>                            |                 |                 |
| Të pagueshmet tregtare                          | 208.00          | 260.00          |
| Tatimi                                          | 46.00           | 132.00          |
| Kosto financiare e pagueshme                    | <u>108.00</u>   | <u>140.00</u>   |
|                                                 | <u>362.00</u>   | <u>532.00</u>   |
| Total detyrimet                                 | <u>1,192.00</u> | <u>1,552.00</u> |
| <b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>             | <b>2,059.00</b> | <b>2,153.00</b> |

**Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- i) Me 31 dhjetor 2019, Shackleton sh.a rriti pronësinë në aksionet e zakonshme të Bly sh.a nga 20% në 60% për një konsideratë në para prej €48,000. Shackleton sh.a i kishte blerë aksionet e zakonshme prej 20% në Bly sh.a për një konsideratë në para prej €21,000 me 1 janar 2017. Vlerat e drejta të pasurive neto të Bly sh.a-së ishin €105,000 dhe €115,000 me 1 janar 2017 dhe 31 dhjetor 2019 respektivisht. Vlerat e drejta të interesit jo-kontrollues dhe të pronësisë prej 20% me 31 dhjetor 2019 ishin €46,000 dhe €23,000 respektivisht.

Vlerat e drejta të pasurive neto të Bly sh.a prej €115,000 me 31 dhjetor 2019 janë përmbledhur mëposhtë:

|                                       | €'000       |
|---------------------------------------|-------------|
| Patundshmëritë, impiantet dhe paisjet | 157         |
| Banka                                 | 22          |
| Të pagueshmet tregtare                | <u>(64)</u> |
|                                       | <b>115</b>  |

Nuk ka pasur shitje të filialave gjatë vitit deri 31 dhjetor 2019.

- ii) Shackleton sh.a shiti tërë pronësinë prej 30% të aksioneve të zakonshme në De León sh.a me 1 gusht 2019 për një konsideratë në para prej €77,000. Vlerat e drejta të pasurive neto të De León sh.a ishin €190,000 në atë datë. Shackleton sh.a kishte influencë domëthënëse në De León sh.a. Shackleton sh.a pranoi dividenda prej €4,000 nga investimet në kompanitë ortakëri për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019.

Nuk ka pasur investime të reja të blera në ortakëri gjatë vitit.

- iii) Gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2019, Shackleton sh.a shiti një paisje me vlerë bartëse prej €66,000 me një humbje prej €9,000. Nuk ka pasur shitje tjera të pasurive jo-qarkulluese.

Zhvlerësimi për vitin arriti shumën prej €92,000. Ky zhvlerësim dhe humbja mësipër i janë ngarkuar kostos së shitjes.

- (iv) Gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2019, Shackleton sh.a pagoi kontribute të pensioneve prej €243,000 tek skema e saj e përfitimeve të paracaktuara. Skema pagoi përfitime të pensioneve prej €58,000 gjatë vitit.

Neto përfitimet nga vlerësimet e ekspertëve (aktoriale) janë dërguar të premia e aksioneve përderisa neto shpenzimet e pensioneve janë ngarkuar tek kostot administrative.

- v) Zëri i mirë i konsoliduar ishte dëmtuar gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2019. Kjo është për filialn e blerë nga Shackleton sh.a para tre (3) viteve. Zëri i mirë në Bly sh.a nuk është dëmtuar që nga blerja.
- vi) Gjatë vitit të përfunduar deri me 31 dhjetor 2019, Shackleton sh.a emetoi aksione të zakonshme për para dhe pagoi dividenda të zakonshme.

- vii) Është politikë e grupit Shackleton sh.a të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë në datën e blerjes.

**Kërkohet:**

**Përgatitet një pasqyrë të rrjedhës së arkës për grupin Shackleton sh.a duke përdorur metodën indirekte, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 në pajtim me kërkesat e SNK 7 *Pasqyra e rrjedhës së arkës*. (30 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

### Grupi Shackleton sh.a

#### Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhës së Arkës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

|                                                                    | €'000 | €'000           |
|--------------------------------------------------------------------|-------|-----------------|
| <b><u>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operacionale</u></b>       |       |                 |
| Fitimi para tatimit                                                |       | 38.00           |
| Korigjimet:                                                        |       |                 |
| Pjesa e humbjeve të ortakërisë                                     |       | 96.00           |
| Kosto financiare                                                   |       | 72.00           |
| Zhvlerësimi                                                        |       | 92.00           |
| Neto shpenzimet e pensioneve L16                                   |       | 133.00          |
| Humbja nga shitja e paisjes                                        |       | 9.00            |
| Fitimi nga shitja e De León sh.a (77 - 57L13)                      |       | (20.00)         |
| Dëmtimi i zërit të mirë L12                                        |       | 4.00            |
| Dëmtimi i investimit në shoqëri L13                                |       | 7.00            |
| Zvogëlimi i stokeve (167 - 160)                                    |       | 7.00            |
| Zvogëlimi i të arkëtueshmeve tregtare (263 -224)                   |       | 39.00           |
| Zvogëlimi i të pagueshmeve tregtare [208 - (260 + 64)]             |       | <u>(116.00)</u> |
| Paraja e gjeneruar nga operacionet                                 |       | 361.00          |
| Kontributet e pensioneve të paguara                                |       | (243.00)        |
| Tatimi i paguar L14                                                |       | (33.00)         |
| Interesi i paguar L17                                              |       | <u>(104.00)</u> |
| <b>Neto rrjedhat dalëse të parasë nga aktivitet operacionale</b>   |       | <b>(19.00)</b>  |
| <b><u>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</u></b>         |       |                 |
| Shitja e aksioneve në De León sh.a                                 |       | 77.00           |
| Blerja e aksioneve shtesë në Bly sh.a (48 - 22)                    |       | (26.00)         |
| Blerja e PIP L11                                                   |       | (116.00)        |
| Arkëtimet nga shitja e PIP (66 - 9)                                |       | 57.00           |
| Dividendat e pranuar nga shoqëritë                                 |       | <u>4.00</u>     |
| <b>Neto rrjedhat dalëse të parasë nga aktivitete investuese</b>    |       | <b>(4.00)</b>   |
| <b><u>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</u></b>         |       |                 |
| Arkëtimet nga shitja e aksioneve                                   |       | 276.00          |
| Dividendat e paguara IJK-së L15                                    |       | (58.60)         |
| Dividendat tjera të paguara (39+18.4 - 29)                         |       | (28.40)         |
| Pagimi i kredisë (444 - 544)                                       |       | <u>(100.00)</u> |
| <b>Neto rrjedhat hyrëse të parasë nga aktivitetet financialese</b> |       | <b>89.00</b>    |
| Rritja në paranë & ekuivalentët e parasë                           |       | 66.00           |
| Paraja & ekuivalentët e parasë në fillim                           |       | <u>60.00</u>    |
| Paraja & ekuivalentët e parasë në fund                             |       | 126.00          |

**Llogaritjet****L11 Patundshmëritë, impiantët dhe paisjet****€'000**

|                     |               |
|---------------------|---------------|
| Saldo në fillim     | 1,099.00      |
| Zhvlerësimi         | (92.00)       |
| Blerja e Bly sh.a   | 157.00        |
| Shitja e paisjes    | (66.00)       |
| blerja (shif. bal.) | <u>116.00</u> |
| Saldo në fund       | 1,214.00      |

**L12 Zëri i mirë****€'000**

|                                          |               |
|------------------------------------------|---------------|
| Saldo në fillim                          | 110.00        |
| Blerja e Bly sh.a [(48 + 23 + 46) - 115] | 2.00          |
| Dëmtimi (shif. bal.)                     | <u>(4.00)</u> |
| Saldo në fund                            | 108.00        |

**L13 Investimet në ortakëri****€'000**

|                                       |               |
|---------------------------------------|---------------|
| Saldo në fillim                       | 414.00        |
| Shitja - De León sh.a (30% x 190,000) | (57.00)       |
| Shitja e - Bly sh.a                   | (23.00)       |
| Pjesa e humbjes                       | (96.00)       |
| Dëmtimi (shif. bal.)                  | (7.00)        |
| Dividendat e pranuar                  | <u>(4.00)</u> |
| Saldo në fund                         | 227.00        |

**L14 Tatimi****€'000**

|                              |                |
|------------------------------|----------------|
| Saldo në fillim (132 - 40)   | 92.00          |
| Fitimi ose humbja            | 15.00          |
| Paraja e paguar (shif. bal.) | <u>(33.00)</u> |
| Saldo në fund (46+28)        | 74.00          |

**L15 Interesi jo-kontrollues****€'000**

|                                 |                |
|---------------------------------|----------------|
| Saldo në fillim                 | 185.00         |
| Blerja e Bly sh.a               | 46.00          |
| Fitimi ose humbja               | 4.60           |
| Dividenda e paguar (shif. bal.) | <u>(58.60)</u> |
| Saldo në fund                   | 177.00         |

|                                                         |                  |
|---------------------------------------------------------|------------------|
| <b>L16 Përfitimet e punonjësve</b>                      | <b>€'000</b>     |
| Saldo në fillim                                         | 476.00           |
| Neto përfitimet nga vlerësimet e ekspertëve (aktoriale) | (8.00)           |
| Neto shpenzimet e pensioneve (shif. bal.)               | 133.00           |
| Përfitimet e pensioneve të paguara (58 - 58)            | -                |
| Kontributet e paguara                                   | <u>(243.00)</u>  |
| Saldo në fund                                           | 358.00           |
| <br><b>L17 Interesi i pagueshëm</b>                     | <br><b>€'000</b> |
| Saldo në fillim                                         | 140.00           |
| Fitimi ose humbja                                       | 72.00            |
| Paraja e paguar (shif. bal.)                            | <u>(104.00)</u>  |
| Saldo në fund                                           | 108.00           |

## Problemi 2

a) Një ndërtesë e fabrikës ishte blerë me 31 dhjetor 2009 për €2,600,000 dhe zhvlerësohet në baza drejtvizore përgjatë jetës së dobishme prej 30 viteve. Vlera e mbetur e vlerësuar e fabrikës është 10% e kostos.

Në nëntor 2019, një eksplodim ndodhi në fabrikë. Fabrika u dëmtua pjesërisht. Kompania e cila e ka në pronësi fabrikën vendosi që ta testoj për dëmtim ndërtesën e fabrikës. Vlera e drejtë e vlerësuar me 31 dhjetor 2019 e ndërtesës së fabrikës ishte €650,000 (€1,000,000 minus kosto për ta shitur €350,000) dhe vlera në përdorim me 31 dhjetor 2019 ishte €1,500,000.

**Kërkohet:**

i) A ka ndonjë humbje nga dëmtimi dhe sa është ajo nëse ka? (trego llogaritjet) (4 pikë)

ii) A do të ndryshonte përgjigja e juaj në (i) mësipër nëse vlera e drejtë e ndërtesës do të ishte €2,250,000 me 31 dhjetor 2019? (2 pikë)

b) Gjate vitit, Amundsen sh.a dërgoi stafin në një kurs të trajnimit dhe shkaktoi shpenzime në shumë prej €150,000. Trajnimi ka përmirësuar eficiencën e stafit gjë që ka rezultuar me kursim të kostove. Organizatori i kursit ka thënë se përfitimet nga trajnimi duhet të zgjasin të paktën dy vite. Asistenti financiar i ka trajtuar kostot e trajnimit si një pasuri e patrupëzuar dhe i ka amortizuar përgjatë kohëzgjatjes së përfitimeve të cilat do të mirren si rezultat i trajnimit.

**Kërkohet:**

Trego nëse asistenti financiar ka kontabilizuar shpenzimet e trajnimit në pajtim me SNK 38 *Pasuritë e patrupezuara*. Nëse jo trego se si duhet të veprohet ndryshe. (4 pikë)

## Zgjidhja e problemit 2

a)

Dëmtimi

i) Humbja nga dëmtimi

|                                       | €                | €                |
|---------------------------------------|------------------|------------------|
| Kosto e ndërtesës së fabrikës         |                  | 2,600,000        |
| Shuma e zhvlerësueshme                |                  |                  |
| Kosto e ndërtesës së fabrikës         | 2,600,000        |                  |
| Vlera e mbetur (10% e koston)         | <u>(260,000)</u> |                  |
|                                       | 2,340,000        |                  |
| Zhvlerësimi vjetor                    | 78,000           |                  |
| Zhvlerësimi për 10 vite               |                  | <u>(780,000)</u> |
| Shuma bartëse e ndërtesës së fabrikës |                  | 1,820,000        |
| Shuma e rikuperueshme                 |                  | <u>1,500,000</u> |
| <b>Humbja nga dëmtimi</b>             |                  | <b>320,000</b>   |

ii) Vlera e drejtë e ndërtesës €2,250,000

|                                       | €                | €           |
|---------------------------------------|------------------|-------------|
| Shuma bartëse e ndërtesës së fabrikës |                  | 1,820,000   |
| Shuma e rikuperueshme më e larta e    |                  |             |
| Vlerës së drejtë                      | 2,250,000        |             |
| Minus kosto për ta shitur             | <u>(350,000)</u> |             |
|                                       | 1,900,000        |             |
| dhe vlerës në përdorim                | 1,500,000        |             |
| Shuma e rikuperueshme                 |                  | 1,900,000   |
| <b>Humbja nga dëmtimi</b>             |                  | <b>Zero</b> |

b) Shpenzimet në kurse të trajnimit mund të shfaqin karakteristika të një pasurie në atë se ato do të vazhdojnë të sjellin përfitime ekonomike në të ardhmen duke rritur eficiencën dhe zvogëlimin e kostove. Megjithatë, SNK 38 nuk lejon që shpenzimet e trajnimit të njihen si pasuri, andaj duhet të njihen si shpenzime posa të shkaktohen. Arsyeja qëndron në çështjen e “kontrollit”. Punonjësit kanë aftësitë që i kanë fituar në trajnim por ata mund të lënë punën në kompani dhe t’i marrin aftësitë e tyre me veti.

### **Problemi 3**

**a)** Drake sh.a prodhon dhe shet një varg të barnave nëpërmjet tri divizioneve. Përveç kësaj, ka edhe dy laborator të cilët kryejnë aktivitetet të hulumtimit dhe zhvillimit.

Në laboratorin e parë, aktiviteti i hulumtimit dhe zhvillimit financohet nga brenda dhe niveli qendror për secilin nga tri divizionet e shitjes. Nuk kryen aktivitetet të hulumtimit dhe zhvillimit për entitete tjera. Secilit prej ketyre tri divizioneve i alokohet një buxhet i cili përdoret për të blerë aktivitetet të hulumtimit dhe zhvillimit nga laboratorin. Laboratori është drejtpërdrejt përgjegjës ndaj kryesuesve të divizioneve për këtë shpenzim.

Laboratori i dytë kryen aktivitete investiguese për laboratorët e tjerë dhe kompanitë tjera farmaceutike. Ky laborator fiton 75% të të hyrave të tij nga klientët e jashtëm dhe këto të hyra nga jashtë paraqesin 18% të totalit të të hyrave të organizatës. Performanca e aktiviteteve të laboratorit të dytë dhe e tri divizioneve të veçanta rishikohet rregullisht nga zyrtari kryesor për marrjen e vendimeve operative. Përveç kryesuesve të divizioneve, është edhe një kryesues i laboratorit të dytë. Kryesuesi i laboratorit të dytë është drejtpërdrejt përgjegjës tek zyrtari kryesor për marrjen e vendimeve operative dhe ata diskutojnë aktivitetet operative, alokimin e resurseve dhe rezultatet financiare të laboratorit.

**Kërkohet:**

**Këshilloni Drake sh.a nëse laboratorët për hulumtim dhe zhvillim duhet të raportohen si dy segmente të ndara sipas SNRF 8 *Segmentet operative*. (8 pikë)**

**b)** Cabot sh.a, një kompani e listuar në bursë, rregullisht blen hekur nga një furnitor jashtë vendit dhe e përcakton blerjen në të ardhmen të hekurit si një zë i mbrojtur në një mbrojtje nga rrjedhat e parasë. Hekuri është blerë me 1 janar 2019 dhe në atë datë, një përfitim kumulativ nga instrumenti i mbrojtjes prej €3 milion është kredituar tek të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse. Në fund të vitit me 31 dhjetor 2019, shuma bartëse e hekurit ishte €8 milion dhe vlera e tij e realizueshme ishte €6 milion. Hekuri më në fund është shitur me 3 shkurt 2020 për €6.2 milion.

**Kërkohet:**

**Trego se si duhet të kontabilizohet transaksioni mësipër në pasqyrat financiare të Cabot sh.a-së në fund të vitit me 31 dhjetor 2019. (7 pikë)**

**c)** Cortes sh.a bleu një zë të patudshmërisë, impianteve dhe paisjeve për €10 milion me 1 janar 2018. Pasuria zhvlerësohet përgjatë pesë viteve në baza drejtvizore dhe nuk ka vlerë të mbetur. Me 31 dhjetor 2018, pasuri u rivlerësua në €12 milion. Me 31 dhjetor 2019, vlera e pasurisë ka rënë në €4 milion. Entiteti bën transfer nga teprica e rivlerësimit në fitimet e mbajtura për zhvlerësimin shtesë, me përdorimin e pasurisë.

**Kërkohet:**

### Zgjidhja e problemit 3

(a) SNRF 8 *Segmentet operative* thotë që një segment operativ është një komponent i një entiteti i cili angazhohet në aktivitetet biznesore nga i cili mund të fitoj të ardhura dhe shkaktoj shpenzime. Për më tepër, informatat financiare diskrete duhet të jenë në dispozicion për segmentin dhe këto rezultate duhet të rishikohen rregullisht nga zyrtari kryesor për marrjen e vendimeve operative gjatë marrjes së vendimeve lidhur me alokimin e resurseve tek segmenti dhe vlerësimin e performancës së tij. Megjithatë, nëse një funksion është pjesë integrale e biznesit, mund të shpaloet si një segment edhe pse mund të mos fitoj të ardhura.

Faktorët tjerë që mund të mirren parasysh gjatë identifikimit të segmenteve operative. Këto përfshijnë natyrën e biznesit të secilës komponentë, ekzistencën e menaxherëve përgjegjës për ato, dhe informatat e prezantuara tek bordi i drejtorëve.

SNRF 8 gjithashtu ka disa matje të caktuara kuantitative për të identifikuar një segment, edhe pse një entitet mund të raportoj informatat për segmentete për segmente operative më të vogla nëse beson që ajo informatë është e dobishme.

Sipas SNRF 8, një segment është operativ nëse përmbushen ndonjëra përj kufijve kuantitativ më poshtë:

(a) Të hyrat e raportuara janë 10% apo më shumë se sa të hyrat e kombinuara të të gjithë segmenteve operative (të jashtme dhe ndërsegmentale), ose.

(b) Shuma absolute e fitimit dhe humbjës së tij të raportuar është 10% ose më shumë së më e larta e, në shumën absolute, të gjithë segmenteve që nuk raportojnë humbje, dhe të gjithë segmenteve që raportojnë humbje, ose.

(c) Pasuritë e tij janë 10% ose më shumë së total pasuritë e të gjithë segmenteve operative.

Sa i përket dy laboratorëve, faktorët kualitativ dhe kuantitativ duhet të merren parasysh në përcatimin si segmente operative.

Duke qënë se për laboratorin 1 zyrtari kryesor për marrjen e vendimeve operative nuk i rishikon informata financiare dhe nuk ka informata financiare diskrete të veçanta për atë segment. të tilla ky laborator nuk do të raportohet si segment operativ.

Laboratori i dytë duhet të raportohet si segment operativ. Ai i përmbush kriteret kuantitativ për përqindjen e totalit të të hyrave, kryen aktivitetet të cilat sjellin të hyra dhe shkaktojnë shpenzime si dhe rezultatet e tij rishikohen nga zyrtari kryesor për marrjen e vendimeve operative. Dhe në fund ka një menaxher të posaçëm.

**(b)** Me 31 dhjetor 2019, Cabot sh.a duhet ta shlyej vleren e hekurit në pajtim me SNK 2 *Stoqet*, në vlerën neto të realizueshme prej €6 milion, duke e zvogëluar fitimin për €2 milion. Cabot sh.a duhet të riklasifikoj një shumë ekuivalente prej €2 milion nga ekuiteti në fitim ose humbje. Pra nuk ka impakt neto nga shlyerja e stoqeve. Përfitimi i mbetur prej €1 milion në ekuitet do të afektoj fitimin ose humbjen kur hekuri të shitet. Andaj me 3 shkurt 2020, përfitimi nga shitja prej €0.2 milion do të njihet në fitim ose humbje, dhe përfitimi i mbetur prej of €1 milion do të transferohet në fitim ose humbje nga ekuiteti.

**c)** Sa i përket patudshmërisë, impianteve dhe paisjeve, me 31 dhjetor 2018, ka një tepricë të rivlerësimit prej €4 milion që është diferenca ndërmjet shumës bartëse prej €8 milion (€10 milion – €2 milion) dhe shumës së rivlerësuar në €12 milion. Ky përfitim nga rivlerësimi njihet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Me 31 dhjetor 2019 vlera e pasurisë ka rënë në €4 milion dhe shuma bartëse e pasurisë është €9 milion (€12 milion – €3 milion). Entiteti do të këtë transferuar €1 milion nga teprica e rivlerësimit tek fitimet e mbajtura që është diferenca ndërmjet zhvlerësimit sipas kostos historike prej €2 milion dhe atij sipas shumës së rivlerësuar prej €3 milion. Humbja nga rivlerësimi prej €5 milion do të ngarkohet së pasi në tepricën e rivlerësimit të mbetur në ekuitet (€4 milion – €1 milion), pra €3 milion dhe pjesa e mbetur prej €2 milion do të ngarkohet në fitim ose humbje.

#### Problemi 4

Battuta sh.a mirret me prodhimin, paketimin dhe marketingun e produkteve teknologjike. Më poshtë është bilanci vërtetues i Battuta sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:

|                                                                          | <b>Debi</b><br><b>€'000</b> | <b>Kredi</b><br><b>€'000</b> |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Të hyrat                                                                 |                             | 169,000                      |
| Kosto e shitjeve                                                         | 69,310                      |                              |
| Dividenda e gjysëm vitit e paguar                                        | 16,000                      |                              |
| Shpenzimet administrative                                                | 31,025                      |                              |
| Shpenzimet e shpërndarjes                                                | 28,331                      |                              |
| Kosto financiare                                                         | 1,900                       |                              |
| Tatimi në fitim i pagueshëm                                              |                             | 1,208                        |
| Toka sipas vlerës së drejtë me 1 janar 2019                              | 142,600                     |                              |
| Ndërtesat sipas koston me 1 janar 2019                                   | 90,650                      |                              |
| Impiantet e prodhimit dhe paisjet sipas koston me 1 janar 2019           | 53,430                      |                              |
| Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2019:                                 |                             |                              |
| Ndërtesat                                                                |                             | 9,065                        |
| Impiantet e prodhimit dhe paisjet                                        |                             | 15,915                       |
| Investimi në pasuri të patundshme sipas vlerës së drejtë me 1 janar 2019 | 4,628                       |                              |
| Kostot e zhvillimit                                                      | 60,800                      |                              |
| Investimet në depozit të afatizuar                                       | 21,200                      |                              |
| Aksionet e zakonshme (€5 për aksion)                                     |                             | 240,000                      |
| Fitimet e mbajtura me 1 janar 2019                                       |                             | 63,256                       |
| Rezerva e rivlerësimit me 1 janar 2019                                   |                             | 16,000                       |
| 5% Obligacione                                                           |                             | 28,000                       |
| Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet tregtare                               | 4,184                       | 1,152                        |
| Tatimi i shtyrë                                                          |                             | 2,451                        |
| Paraja dhe banka                                                         | 16,680                      |                              |
| Stoqet                                                                   | 3,658                       |                              |
| Tatimi në fitim i paguar                                                 | <u>1,651</u>                | <u>          </u>            |
|                                                                          | <b>546,047</b>              | <b>546,047</b>               |

### Informata shitesë:

- i) Battuta sh.a vendosi të adoptoj modelin e rivlerësimit për ndërtesat dhe vlera e drejtë me 1 janar 2019 është €90,000,000. Jeta e dobishme e mbetur e përdorimit në atë datë është 25 vite. Vlera e drejtë e tokës me 31 dhjetor 2019 është €150,000,000. Të dy rivlerësimet akoma nuk janë regjistruar në pasqyrat në fund të vitit. Për më tepër, Battuta sh.a dëshiron të bëj transfere vjetore tek fitimet e mbajtura të teprcës së rivlerësimit gjatë përdorimit dhe zhvlerësimit të pasurisë.
- ii) Me 1 janar 2019, Battuta sh.a hyri në një marrëveshje 4 vjeçare të lizingut financiar me Tangier sh.a për një makineri. Pagesat vjetore të lizingut ishin €1,200,000 të pagueshme në fund të vitit. Vlera e tanishme e pagesave të lizingut është €4,158,120 që është e barabartë me vlerën e drejtë të makinerisë. Jeta e dobishme e vlerësuar e pasurisë është 4 vite. Asnjë transaksion lidhur me lizingun nuk është regjistruar në pasqyra deri në fund të vitit. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing ishte 6%.
- iii) Një paisje e re që kushtoi €1,650,000 ishte blerë me 1 janar 2019 për të zëvendësuar një paisje të vjetër që ishte blerë me 1 janar 2015 me kosto prej €1,220,000. Paisja e vjetër ishte shitur për €885,000. Anjë nga këto transaksione nuk është regjistruar në libra deri në fund të vitit.

Implantet e prodhimit dhe paisjet zhvlerësohen përgjatë 10 viteve. I tërë zhvlerësimi është i përfshirë në shpenzimet administrative.

Politika e kompanisë është që të zhvlerësohen të gjitha pasuritë duke përdorur metodën drejtvizore, duke e ngarkuar tërë zhvlerësimin e vitit në vitin e blerjes dhe asnjë në vitin e shitjes.
- iv) Një implant i cili është blerë me 1 qershor 2012 me një kosto prej €1,340,000 kishte zvogëlim në kapacitetin prodhues që nga marsi 2019. Kjo ka shkaktuar disa ndalesa në procesin e prodhimit. Bordi i drejtorëve të Battuta sh.a vendosi që të testoj për dëmtim implantin në fund të vitit. Vlera e drejtë e implantit me 31 dhjetor 2019 është €350,000. Nëse implanti shitet, një kosto e çmontimit prej €12,400 shkaktohet. Shuma e dëmtimit ende nuk është regjistruar në libra.
- v) Battuta sh.a bleu një ndërtesë me kosto prej €2,500,000 me 1 janar 2014. Ndërtesa i është dhënë me qira organizatave të ndryshme, dhe klasifikohet për tu kontabilizuar si investim në pasuri të patundshme sipas SNK 40 *Investimet në pasuri të patundshme*. Jeta e vlerësuar e ndërtesës është 30 vite.

Me 31 dhjetor 2019, vlera e drejtë e ndërtesës është €5,350,000. Kompania adopton modelin e vlerës së drejtë në matjen e investimeve në pasuri të patundshme pas njohjes fillestare. Rivlerësimi ende nuk është është inkorporuar në librat e Battuta sh.a-së në fund të vitit. Megjithatë, në atë datë kompania vendosi të okupoj ndërtesën si një zyre qendrore e dytë për operacionet e biznesit. Në fund të vitit, riklasifikimi i ndërtesës ende nuk është regjistruar në libra.

- vi) Drejtorët kanë vlerësuar se shpenzimi i tatimit në fitim për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 është €1,512,000, duke përjashtuar tatimin e shtyrë. Provizionin e tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2019 është €3,455,000.

**Kërkohet:**

- i) **Përgatite Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. (Të tregohet edhe fitimi për aksion)** (8 pikë)
- ii) **Përgatite Pasqyrën e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2019.** (12 pikë)

## Zgjidhja e problemit 4

a)

### Battuta sh.a

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019**

|                                                                  |                     |
|------------------------------------------------------------------|---------------------|
| Të hyrat                                                         | 169,000,000         |
| Kosto e shitjeve                                                 | <u>(69,310,000)</u> |
| Fitimi bruto                                                     | 99,690,000          |
| Rritja në VD të IPP (5,350 – 4,628)                              | 722,000             |
| Fitimi nga shitja e PPIPP 885 – ((1,220 – (1,220 / 10 x 4 vite)) | 153,000             |
| Shpenzimet administrative (L12)                                  | (41,114,930)        |
| Shpenzimet e shpërndarjes                                        | (28,331,000)        |
| Kosto financiare 1,900,000 + 249,487(L11)                        | <u>(2,149,487)</u>  |
| Fitimi para tatimit                                              | 28,969,583          |
| Shpenzimet e tatimit 1,512 + 1,004                               | <u>(2,516,000)</u>  |
| <b>Fitimi pas tatimit</b>                                        | <b>26,453,583</b>   |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                              |                     |
| Teprica në rivlerësim:                                           |                     |
| Toka 150,000 -142,600                                            | 7,400,000           |
| Ndërtesat 90,000 - (90,650 – 9,065)                              | <u>8,415,000</u>    |
| <b>Total ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                          | <b>42,268,583</b>   |

FPA 26,453,583 / 48,000,000 AZ = €0.55

\*€240,000,000/ €5 për aksion = 48,000,000 AZ

### L11- Lizingu

|                                              |            |            |
|----------------------------------------------|------------|------------|
| D Pasuria                                    | €4,158,120 |            |
| K Detyrimi ndaj lizingut                     |            | €4,158,120 |
| Zhvlerësimi: €4,158,120/4 vite = €1,039,530  |            |            |
| D Zhvlerësimi                                | €1,039,530 |            |
| K Zhvlerësimi i akumuluar                    |            | €1,039,530 |
| Kosto financiare: €4,158,120 x 6% = €249,487 |            |            |
| D Kosto financiare                           | €249,487   |            |
| K Detyrimi ndaj lizingut                     |            | €249,487   |

### L12- Dëmtimi i PPIPP

|                       |                |
|-----------------------|----------------|
| Kosto me 1 janar 2013 | €<br>1,340,000 |
|-----------------------|----------------|

|                                           |                |
|-------------------------------------------|----------------|
| Zhvlerësimi i akumuluar 1,340/10 x 7 vite | <u>938,000</u> |
| Vlera bartëse me 31 dhjetor 2019          | 402,000        |

Shuma e rikuperueshme:

VD minus kostot e shitjes (350 -12.4) 337,600

Dëmtimi **64,400**

|                                       |                   |
|---------------------------------------|-------------------|
| <b>L13- Shpenzimet administrative</b> | <b>€</b>          |
| Sipas BV                              | 31,025,000        |
| Zhvlerësimi (Shenim PPIPP)            | 10,025,530        |
| Dëmtimi i PPIPP (L12)                 | <u>64,400</u>     |
|                                       | <b>41,114,930</b> |

**b)**

**Battuta sh.a**

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019**

*Pasuritë jo-qarkulluese*

Pasuri të patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet

Shënim PPIPP 277,851,190

Investimet në pasuri të patundshme 4,628 +722 – 5,350 -

Kostot e zhvillimit 60,800,000

Investimet në depozit të afatizuar 21,200,000

*Pasuritë qarkulluese*

Të arkëtueshmet tregtare 4,184,000

Banka 16,680,000 – 1,650,000 +885,000 – 1,200,000 14,715,000

Stoqet 3,658,000

**Total pasuritë 382,408,190**

*Ekuiteti*

Aksionet e zakonshme 240,000,000

Fitimet e mbajtura (L1 4) 74,046,183

Rezerva e rivlerësimit (L1 4) 31,478,400

*Detyrimet afatgjata*

5% Obligacion 28,000,000

Tatimi i shtyrë 3,455,000

Detyrimi ndaj lizingut 4,158,120 + 249,487 – 1,200,000 3,207,607

*Detyrimet afatshkurtëra*

Të pagueshmet tregtare 1,152,000

Tatimi i pagueshëm 1,208 + 1,512 – 1,651 1,069,000

**Total ekuiteti dhe detyrimet 382,408,190**

**L14 - Fitimet e mbajtura dhe rezervat e rivlerësimit**

|                                   | <b>Fitimet e mbajtura</b> | <b>Rezervat e rivlerësimit</b> |
|-----------------------------------|---------------------------|--------------------------------|
| Sipas BV                          | 63,256,000                | 16,000,000                     |
| Fitimi i vitit                    | 26,453,583                |                                |
| Teprica në rivlerësim:            |                           |                                |
| Toka                              |                           | 7,400,000                      |
| Ndërtesa                          |                           | 8,415,000                      |
| Transferet (8,415/25 vite)        | 336,600                   | <u>(336,600)</u>               |
| Dividenda e gjysëm vitit e paguar | <u>(16,000,000)</u>       |                                |
| <b>Saldo në fund</b>              | <b>74,046,183</b>         | <b>31,478,400</b>              |

|                        | <b>Toka</b> | <b>Ndërtesa</b>    | <b>IP &amp; paisjet</b> | <b>Lizingu</b> | <b>Total</b>       |
|------------------------|-------------|--------------------|-------------------------|----------------|--------------------|
| <b>Kosto/Vlerësimi</b> |             |                    |                         |                |                    |
| Saldo në fillim        | 142,600,000 | 90,650,000         | 53,430,000              | -              | 286,680,000        |
| Shtesat                |             |                    | 1,650,000               | 4,158,120      | 5,808,120          |
| Riklasifikim nga IPP   |             | 5,350,000          |                         |                | 5,350,000          |
| Shitjet                |             |                    | (1,220,000)             |                | (1,220,000)        |
| Teprica në rivlerësim  | 7,400,000   | 8,415,000          |                         |                | 15,815,000         |
| Eliminimi              |             | <u>(9,065,000)</u> |                         |                | <u>(9,065,000)</u> |
| Saldo në fund          | 150,000,000 | 95,350,000         | 53,860,000              | 4,158,120      | 303,368,120        |

**Zhvlerësimi i akumuluar**

|                    |                  |                  |                       |                   |
|--------------------|------------------|------------------|-----------------------|-------------------|
| Saldo në fillim    | 9,065,000        | 15,915,000       | -                     | 24,980,000        |
| Eliminimi          | (9,065,000)      |                  |                       | (9,065,000)       |
| Shitjet            |                  | (488,000)        |                       | (488,000)         |
| Ngarkesa për vitin | <u>3,600,000</u> | <u>5,386,000</u> | <u>1,039,530(L11)</u> | <u>10,025,530</u> |
| Saldo në fund      | 3,600,000        | 20,813,000       | 1,039,530             | 25,452,530        |

**Dëmtimi i akumuluar**

|                      |                    |                   |                   |                    |
|----------------------|--------------------|-------------------|-------------------|--------------------|
| Saldo në fillim      |                    |                   |                   |                    |
| Ngarkesa për vitin   |                    | 64,400            |                   | 64,400             |
| Saldo në fund        |                    | <u>64,400</u>     |                   | <u>64,400</u>      |
| <b>Vlera bartëse</b> | <b>150,000,000</b> | <b>91,750,000</b> | <b>32,982,600</b> | <b>3,118,590</b>   |
|                      |                    |                   |                   | <b>277,851,190</b> |

## **Problemi 5**

**a)** Me 1 janar 2016, Cook sh.a bleu nja markë tregtare të paisjeve teknologjike, Endeavour, për €3 milion. Në fillim, Cook sh.a vlerësoi se do të përfitonte rrjedha të parasë nga kjo markë tregtare pafundësisht.

Por, për shkak të vështirësive në përcaktimin e jëtës së dobishme Cook sh.a vendosi të amortizoj markën tregtare përgjatë 10 viteve me metodën drejtvizore. Në janar 2019, një konkurent papritmas pati një zhvillim të hovshëm teknologjik që do të shpie në një produkt të ri i cili kur të lansohet do të zvogëloj në mënyrë të ndjeshme kërkesën për Endeavour. Kërkesa për produktin Endeavour pritet të mbetet e lartë deri në qershor 2021, kur pritet që konkurenti të lansoj produktin e tij të ri.

Në fund të vitit financiar me 31 dhjetor 2019, Cook sh.a vlerësoi shumën e rikuperueshme të markës tregtare në €500,000 dhe ka për qëllim të vazhdoj prodhimin e Endeavour deri me 30 qershor 2021.

### **Kërkohet:**

**Këshillo drejtorët e Cook sh.a se si të trajtojnë markën tregtare në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.** (7 pikë)

**(b)** Me 31 dhjetor 2019, tre përsone kanë në pronësi të gjitha aksionet e Hudson sh.a-së. Drejtori financiar ka 60%, dhe drejtori i operacioneve ka 30%. Pronari i tretë është një investitor pasiv i cili nuk ndihmon në menaxhimin e entitetit. Të gjitha aksionet e zakonshme bartin të drejta të barabarta të votës. Bashkëshortja e drejtorit financiar është drejtoreshë e shitjes në Hudson sh.a. Djali i tyre është aktualisht duke kryer një program praktike në Hudson sh.a dhe merr pagë prej €30,000 në vit, që është një kompenzim normal.

Drejtori financiar dhe drejtoresha e shitjes e kanë themeluar një kompani investuese Bay sh.a. Ata së bashku e kanë në pronësi Bay sh.a-në dhe aksionet e tyre në Bay sh.a do të transferohen eventualisht tek djali i tyre pasi të përfundoj programin e praktikës në Hudson sh.a.

Për më tepër, me 1 korrik 2019 Hudson sh.a mori një kredi bankare prej €500,000 me një normë fikse të interesit prej 6% në vit. Kredia duhet të ripaguhet me 31 dhjetor 2020. Ripagimi i kryegjësë dhe interesit është i siguruar nga një garancion i regjistruar në favor të bankës kundrejt shtëpisë private të drejtorit financiar.

### **Kërkohet:**

**Këshillo drejtorët e Hudson sh.a lidhur me identifikimin dhe shpalosjen e palëve të lidhura me kompaninë gjatë përgaditjes së pasqyrave financiare individuale (jo-grupore) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.** (7 pikë)

c) Hillary sh.a, një mopnani e listuar në bursë, kryen shumë prej aktiviteteve të saj jashtë shtetit. Valuta funksionale e Hillary sh.a-së është euro.

Hillary sh.a mori një kredi në valutë të huaj prej 5 milion lek me një normë fikse të interesit prej 8% me 1 janar 2019. Interesi paguhet në fund të çdo viti. Kredia do të ripaguhet pas dy viteve me 31 dhjetor 2020. Norma e interesit është norma aktuale e tregut për kredi me normë fikse të ngjajshme.

Hillary sh.a ka fundit e vitit financiar me 31 dhjetor 2019 dhe kursi mesatar i këmbimit për vitin nuk dallon nga norma aktuale gjatë vitit.

| <b>Kurset e këmbimit</b>                                           | <b>€1 = lek</b> |
|--------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 1 janar 2019                                                       | 5               |
| 31 dhjetor 2019                                                    | 6               |
| Kursi mesatar i këmbimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 | 5.6             |

**Kërkohet:**

Hillary sh.a kërkon këshillë nga ju se si të kontabilizoj kredinë dhe interesin në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.

(6 pikë)

(Total: 20 pikë)

## Zgjidhja e problemit 5

a)

SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara* thotë që kosto minus vlera e mbetur e një pasurie të patrupëzuar më një jetë të kufishme të përdorimit duhet të amortizohet në baza sistematike përgjatë asaj jete, dhe që metoda e amortizimit duhet të reflektoj mënyrën e përfitimeve dhe duhet të rishikohet se paku në baza vjetore.

Metoda e amortizimit duhet të rishikohet në baza vjetore dhe nëse mënyra e përfitimit ka ndryshuar, metoda e amortizimit duhet të ndryshohet në mënyrë prospektive si një ndryshim në vlerësim sipas SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Rënia e prituri e shitjeve mund të jetë një tregues i një normë më të lartë të konsumit të përfitimeve ekonomike që janë përfshirë në pasuri. Andaj, marka tregtare duhet të amortizohet përgjatë 2.5 viteve deri në qershor 2021.

SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* thotë që një entitet duhet të vlerësoj në fund të secilës periudhë raportuese nëse ka ndonjë tregues që pasuria mund të jetë dëmtuar. Nëse ekziston një tregues i tillë, entiteti duhet të vlerësoj shumën e rikuperueshme të pasurisë. Pa marrë parasysh a ka a po jo tregues të dëmtimit, një entitet duhet gjithashtu të testoj një pasuri të patrupëzuar me një jetë të pakufishme të përdorimit ose një pasuri të patrupëzuar e cila ende nuk është e disponueshme për përdorim për dëmtin në baza vjetore duke e krahasuar vlerën bartëse të saj me shumën e rikuperueshme. Testi i dëmtimit mund të kryhet në çfardo kohe, por duhet të jënë në të njëjtën kohë çdo vit. Andaj, Cook sh.a duhet të testoj markën tregtare për dëmtim.

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

|                                                                       |          |
|-----------------------------------------------------------------------|----------|
| D Fitim ose humbje (shpenzim operativ) – amortizimi i markës tregtare | €840,000 |
| K Pasuria e patrupëzuar (marka tregtare) – amortizimi i akumuluar     | €840,000 |

*Për të njohur amortizimin vjetor të markës tregtare gjatë periudhës.*

me 31 dhjetor 2019

|                                                                        |          |
|------------------------------------------------------------------------|----------|
| D Fitim ose humbje (shpenzim operativ) – dëmtimi i markës tregtare     | €760,000 |
| K Pasuria e patrupëzuar (marka tregtare me jetë të kufishme) – dëmtimi | €760,000 |

*Për të njohur humbjen nga dëmtimi i markës tregtare.*

### Llogaritjet

Kosto e markës tregtare €3m/10 vite të jetës së dobishme = €300,000 amortizimi vjetor. Andaj vlera bartëse me 1 janar 2019 është (€3m kosto minus (€300,000 amortizimi në vit x 3 vite që nga blerja)) = €2.1m.

Jeta e dobishme e markës tregtare është zvogëluar në 2.5 vite dhe kjo shumë duhet të amortizohet përgjatë kësaj periudhe. €2.1 m/2.5 vite të mbetura të jetës së dobishme = €840,000 në vit.

Andaj shuma bartëse me 31 dhjetor 2019 është €3m kosto minus €900,000 minus €840,000 = €1.26 millon.

Shum e rikuperueshme është €500,000, pra humbja nga dëmtimi është €760,000.

**(b) SNK 24** *Shpjegimet e palëve të lidhura* kërkon që pasqyrat financiare të një entiteti të përmbajnë shpjegimet e nevojshme për të tërhequr vëmendjen në mundësinë që pozita financiare dhe fitimet ose humbjet mund të jenë afektuar nga ekzistenca e palëve të lidhura dhe nga transaksionet apo saldot e papaguar me palë të tilla.

Një person apo anëtar i familjes së afërme të atij personi është i lidhur me entitetin raportues nëse ai person:

- (i) ka kontroll ose kontroll të përbashkët mbi entitetin raportues;
- (ii) ka influencë domëthënëse mbi entitetin raportues; ose
- (iii) është anëtar i personelit të menaxhmentit kyç të entitetit raportues.

Sa i përket Hudson sh.a, drejtori financiar është palë e lidhur, pasi që ai ka më shumë se gjysmen e fuqisë votuese (60%). Në mungesë të ndonjë evidence që dëshmon të kundërtën, ai kontrollon Hudson sh.a dhe është anëtar i personelit të menaxhmentit kyç. Drejtoresha e shitjes është gjithashtu palë e lidhur e Hudson sh.a-së pasi që është anëtare e personelit të menaxhmentit kyç dhe është anëtare e familjes së ngushtë (bashkëshorte) e drejtorit financiar. Djali i tyre është palë e lidhur me Hudson sh.a pasi që është anëtar i familjes së ngushtë të tyre. Drejtori i operacioneve është gjithashtu palë e lidhur pasi që ka më shumë se 20% të fuqisë votuese në Hudson sh.a. Në mungesë të ndonjë evidence që dëshmon të kundërtën, drejtori i operacioneve ka influencë domëthënëse mbi Hudson sh.a dhe është anëtar i personelit të menaxhmentit kyç.

Një entitet është i lidhur me një entitet raportues nëse entiteti kontrollohet apo është në kontroll të përbashkët nga një person i identifikuar si palë e lidhur. Andaj, Bay sh.a është një palë e lidhur me Hudson sh.a. Bay sh.a është nën kontroll të palëve të lidhura, drejtori financiar dhe drejtoresha e shitjeve, për përfitim të një anëtari të afërt të familjes, në këtë rast djali i tyre.

Në mungesë të ndonjë evidence që dëshmon të kundërtën, pronari i tretë i aksioneve nuk është palë e lidhur. Personi është një investitor pasiv i cili me sa duket nuk ushtron influencë domëthënëse mbi Hudson sh.a. Kredia nga banka e cila është e garantuar nga drejtori financiar, do të shpaloset si e tillë në pasqyrat financiare. Shpalosja e garancioneve personale të dhena nga drejtorët lidhur me huamarrjet nga entiteti raportues duhet të shpaloset në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

**c)** Saldo e kredisë, si një zë monetar, përkthehet me kursin aktual të këmbimit në fund të vitit. Interesi përkthehet në kursin mesatar sepse është i përafërt me kursin aktual gjatë vitit. Për shkak se norma e interesit është sipas normës së tregut për kredi të ngjajshme dy vjeçare, Hillary sh.a e matë kredinë në njohjen fillestare me çmimin e transaksionit të përkthyer në valuten funksionale. Pasi që nuk ka kosto të transaksionit norma efektive e interesit është 8%.

Me 1 janar 2019, kredia regjistrohet në njohjen fillestare si në vijim:

|                                          |           |           |
|------------------------------------------|-----------|-----------|
| D Paraja                                 | €1 milion |           |
| K Kredia e pagueshme – detyrim financiar |           | €1 milion |

Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2019

Hillary sh.a regjistron shpenzimet e interesit si në vijim:

|                                             |         |         |
|---------------------------------------------|---------|---------|
| D Fitim ose humbje – shpenzimet e interesit | €71,429 |         |
| K Kredia e pagueshme – detyrim financiar    |         | €71,429 |

*Për të njohur interesin e pagueshëm për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 (0.4 milion lek/5.6).*

Me 31 dhjetor 2019 interesi paguhet dhe hyrja në vijim bëhet:

|                                          |         |         |
|------------------------------------------|---------|---------|
| D Kredia e pagueshme – detyrim financiar | €66,666 |         |
| K Paraja                                 |         | €66,666 |

*Për të njohur pagesën e interesit në 2019 për detyrimin financiar (0.4 milion lek/6).*

Me 31 dhjetor 2019 kredia regjistrohet me 5 milion lek/6, pra €833,333, e cila krijon një përfitim nga kursi i këmbimit prej €166,667. Përveç kësaj, edhe një përfitim nga kursi i këmbimit prej €4,763 krijohet në përkthimin e interesit të paguar (€71,429 – €66,666). Totali i përfitimit nga kursi i këmbimit pra është €171,430.